



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština – Assembly*

**Legjislatura VIII**  
**Sesioni vjeshtor**

---

Komisioni për Punë të Jashtme dhe Diasporë  
Mbledhja nr. 93  
Prishtinë, më 16.9.2024, në orën 11:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-204

**P r o c e s v e r b a l**

**Në mbledhje morën pjesë:** Arbëreshë Kryeziu-Hyseni, Yllza Hoti, Gazmend Gjyshinca, Fitore Pacolli-Dalipi, Ariana Musliu-Shoshi dhe Time Kadrijaj.

**Munguan:** Xhavit Haliti, Adelina Grainca, Doarsa Kica-Xhelili dhe Bahrim Shabani.

**I pranishëm në takim:** z. Béla Bozsik, ambasador i Republikës së Hungarisë në Kosovë, si dhe z. Miklós Varga, zëvendësambasador.

**Pjesëmarrës të tjerë:** Liridona Gashi, Kabinet, Kuvend; Besarta Pllana, Alisa Thaqi, Leudita Mejzini dhe Albana Bucaliu, Kuvend.

**Nga Zyra e Komisionit:** Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

Takimin e kryesoi Arbëreshë Kryeziu-Hyseni, kryetare e Komisionit.

**Rendi i ditës:**

Takim i Komisionit me ambasadorin e Republikës së Hungarisë në Kosovë, z. Béla Bozsik.

**Arbëreshë Kryeziu-Hyseni**, i uroi mirëseardhje ambasadorit dhe theksoi se është kënaqësi të diskutohet për çështjet që i përkasin interesave të të dy shteteve. E uroi Hungarinë për presidencën e radhës të Këshillit të Bashkimit Evropian dhe falënderoi atë për ftesën për pjesëmarrjen e Kosovës në Konferencën parlamentare në Budapest. Po ashtu, e falënderoi ambasadorin për përkrahjen e vazhdueshme të Hungarisë ndaj Kosovës dhe theksoi se marrëdhëniet bilaterale mes Kosovës dhe Hungarisë janë të mira dhe nuk ka çështje të hapura në mes të dy shteteve. Në vijim, tha se Republika e Kosovës është e angazhuar për të forcuar më tej bashkëpunimin ekonomik, si dhe fusha të tjera, si mbrojtja, siguria, kultura, sporti dhe turizmi me Hungarinë. Kosova është mirënjohëse për investimin e Hungarisë në arsimin e Kosovës, veçanërisht për bursat e ofruara për studentët kosovarë që nga viti 2015, nga të cilat kanë përfituar më shumë se 100 studentë. Po ashtu, theksoi se Kosova falënderon Hungarinë për përkrahjen e saj në procesin e liberalizimit të vizave dhe zgjerimin e Bashkimit Evropian, duke theksuar se themelimi i dialogut politik në nivelin më të lartë me NATO-n, kontribuon për stabilitet për gjithë rajonin. Ajo shprehu shqetësimin për mungesën e mbështetjes së Hungarisë për anëtarësimin e Kosovës në Këshillin e Evropës dhe me

këtë rast kërkoi më shumë angazhim për të arritur një mirëkuptim të gjerë nga ana e anëtarëve hungarezë të këtij Këshilli. Më tej, tha se Kosova kërkon mbështetjen e Hungarisë lidhur me pesë vendet mosnjohëse, veçanërisht me fqinjët, si Sllovakia dhe Rumania, dhe në kontekstin e Presidencës hungareze të BE-së, kërkon ndihmë për largimin e masave ndaj Kosovës dhe mbështetje që Kosova të marrë pyetësonin për statusin e kandidatit për BE. Bëri të ditur se ia ka përcjellë një ftesë homologut të saj hungarez, si dhe anëtarëve të Komisionit për Politikë të Jashtme të Hungarisë, për një vizitë në Kosovë.

**Béla Bozsik**, e falënderoi Komisionin për ftesën dhe theksoi se është e rëndësishme të informojë Komisionin për politikën e qeverisë së tij drejt Ballkanit Perëndimor dhe drejt Kosovës. Hungaria është mbështetëse e zgjerimit të BE-së, duke theksuar se kjo është në interesin jo vetëm të vendeve të Ballkanit Perëndimor, por edhe të BE-së dhe vendeve të saj anëtare. Për këtë arsye, Hungaria ka vendosur të ftojë përfaqësuesit e Ballkanit Perëndimor në takime të ndryshme të BE-së gjatë presidencës së saj, për të siguruar që të dëgjohet zëri i vendeve të Ballkanit Perëndimor. Përfaqësuesit e Kosovës janë ftuar në Komunitetin Politik Evropian, në nëntor, ndërsa në dhjetor është planifikuar organizimi i një samiti të vendeve të Ballkanit Perëndimor në Mal të Zi. Lidhur me pyetësonin për statusin e kandidatit për anëtarësim në BE, theksoi se kolegët e tij në Bruksel kanë bërë një kërkesë brenda vendeve anëtare, por për fat të keq, nuk ka konsensus, sidomos për shkak të vendeve mosnjohëse, të cilat janë kundër. Ai tha se Kosova mund të marrë pyetësonin e përdorur nga Tirana dhe Shkupi, pasi që 80% e pyetjeve janë të njëjta dhe kjo do t'i lejojë Kosovës të përgatitet për përgjigjet. Ai theksoi se programi ekonomik i Kosovës, është dorëzuar në kohë në Bruksel dhe Komisioni Evropian ka një opinion pozitiv për të. Viti 2024, tha se është një vit i tranzicionit institucional për BE-në, që e bën këtë periudhë më sfiduese për Presidencën hungareze. Bëri të ditur se formimi i komisionit të ri evropian mund të vonohet, gjë që e vështirëson fillimin e zgjidhjes së çështjeve politike që kërkojnë përfshirjen e Parlamentit dhe komisionit. Prioritetet kryesore të Presidencës hungareze, tha se janë: arritja e një marrëveshjeje të re evropiane për konkurrencën, pasi që BE-ja po humb terren ndaj SHBA-së dhe Kinës, në këtë fushë; së dyti, forcimi i politikës evropiane të mbrojtjes, veçanërisht duke pasur parasysh luftën mes Rusisë dhe Ukrainës, që ka treguar se BE-ja dhe vendet anëtare ishin të papërgatitura. Prioriteti i tretë, është një politikë e konsistente dhe e bazuar në merita për zgjerimin, duke marrë parasysh realitetet e reja politike, si kandidaturat e vendeve lindore dhe rëndësinë për të mos harruar vendet e Ballkanit Perëndimor, që janë më mirë të përgatitura. Së katërti, është ndalimi i migracionit të paligjshëm, me qëndrimin se vendet kanë të drejtë të mbrojnë kufijtë e tyre dhe migracioni i paligjshëm mund të destabilizojë vendet anëtare të BE-së. Një tjetër prioritet, tha se është politika e kohezionit për të mbështetur rajonet që nuk arrijnë 75% të GDP-së për kokë banori, në krahasim me mesataren e BE-së; si dhe politika bujqësore, duke mbështetur fermerët dhe duke shmangur favorizimin e kompanive të mëdha. Prioriteti i fundit i Presidencës së Hungarisë, tha se është adresimi i sfidave demografike, me theks në humbjen e popullsisë në Ballkanin Perëndimor, që ndikon negativisht në rritjen ekonomike të rajonit. Po ashtu, z. Bozsik theksoi se vendet anëtare duhet të zgjidhin mungesën e fuqisë punëtore përmes mbështetjes së familjeve dhe jo përmes migracionit, duke ndihmuar prindërit dhe duke mos tërhequr popullsinë nga vendet e Ballkanit Perëndimor.

**Ariana Musliu- Shoshi**, theksoi se e kupton situatën e brishtë, migrimin ilegal dhe efektet e ndryshimit të klimës, por bazuar në agjendën strategjike, PE e KE duhet të jenë aktivë dhe të luajnë rolin e plotë të tyre. Paqja dhe stabiliteti i Evropës është shumë i rëndësishëm, por për shtetet e Ballkanit Perëndimor është dyfish më i rëndësishëm stabiliteti i BE-së. Po ashtu, tha se Hungaria ka qenë një nga forcat kryesore që Kosova të ecën përpara. Ne kemi pasur mbështetjen nga Hungaria në Projektin e binjakëzimit, i cili projekt ishte një nga shtyllat kryesore për Kuvendin tonë, por theksoi se diç papritmas ka ndryshuar. Pyeti: çka ka ndryshuar në lidhje me politikën e jashtme të Hungarisë për Kosovën, si e konsiderojnë mbështetjen për Serbinë më shumë se sa për Kosovën? Përderisa e dimë se Serbia është në linjë me Rusinë. Serbia është i vetmi vend, i cili nuk ka vu sanksione, përderisa ne, me kapacitetet që kemi pasur, kemi ndihmuar Ukrainën. Znj. Musliu

Shoshi, pyeti: Si do të ndryshohet qasja që Hungaria të jetë mbështetëse më e fortë për Kosovën, përderisa e dimë se udhëheq me komitete më me ndikim në Asamblenë Parlamentare?

**Béla Bozsik**, theksoi se marrëdhëniet bilaterale janë pjesë e politikës rajonale dhe Hungaria e mbështet Kosovën. Hungaria e mbështet Kosovën me pjesëmarrje në KFOR, përkrah zgjerimin, ka dërguar nga një këshilltar në çdo vend të Ballkanit Perëndimor, e po ashtu edhe një këshilltar në stafin e zëvendëskryeministrit Besnik Bislimit. Rreth 400 studentë nga Kosova janë duke studiuar në Hungari, e po ashtu tha se i kanë ofruar ndihmë Kosovës, porse është për keqardhje që nuk ka propozuar asnjë projekt. Ambasadori z. Bozsik njoftoi edhe për raportet Serbi-Hungari dhe përmirësimin e tyre pas takimeve nga viti 2011. Kosova dhe shqiptarët, tha se kanë përgjegjësinë më të madhe për të siguruar rrethana të cilat do të bëjnë të mundshme që komuniteti serb të mbrojë identitetin e tyre nacional e kulturor. Të dyja palët, tha se duhet të gjejnë zgjidhjen përmes dialogut me mjete paqësore.

**Ariana Musliu- Shoshi**, theksoi se Kosova duhet të mbështetet për anëtarësim në organizata ndërkombëtare dhe të kemi stabilitet. Serbia, përkundër Marrëveshjes së Brukselit, është duke lobuar që Kosova të mos anëtarësohet në organizata ndërkombëtare dhe po shpenzon financiarisht që të parandalojë Kosovën që të integrohet. Në vijim, tha se Hungaria duhet të marrë më shumë parasysh interesin e përgjithshëm të BE-së, sesa marrëdhëniet e saj bilaterale. Sa i përket komuniteteve, bëri të ditur se ka raporte nga ekspertë ligjorë të KiE-së, janë dy raporte të cilat thonë se Kosova është mirë e avancuar, sa i përket të drejtave të komuniteteve, në krahasim me vendet e tjera të BE-së. Asnjë vend demokratik nuk mund të ofrojë më shumë të drejta për komunitete sesa Kosova. Kosova ka nevojë për njohje të reja e integritime evropiane, tha ajo.

**Béla Bozsik**, theksoi se arsyeja e refuzimit të Kosovës në Strasburg ishte mosdërgimi i draft-statutit për asociacionin në Gjykatën Kushtetuese. Ndërsa, kur Gjeorgjia e Ukraina e morën statusin e vizave, atë kohë edhe Kosova ka pasur shanse ta marrë liberalizimin e vizave, sikur të ratifikohesh marrëveshja me Malin e Zi. Ai tha se Kosova e ka nënshkruar një marrëveshje ndërkombëtare, që pritet të themelojë asociacionin dhe se Qeveria e Kosovës e ka sfiduar BE.

**Arbëreshë Kryeziu- Hyseni**, sa i përket ratifikimit të marrëveshjes me Malin e Zi, tha se ne e kemi plotësuar këtë kriter, por nuk pati liberalizim të vizave dhe kemi mjaft shembuj nga e kaluara se gjithmonë do të ketë ndonjë kërkesë të re për Kosovën, që duhet ta miratojë apo ta realizojë. Ne e kemi pranuar propozimin dhe marrëveshjen bazë dhe jemi të gatshëm ta realizojmë, por është e padrejtë të kërkosh diç nga Kosova, e në anën tjetër, të mos flasësh për qëndrimin e Serbisë për planin e aksionit, për marrëveshjen bazë. Ne nuk e dimë ende nëse Serbia është pjesë e dialogut. Për dialog nevojiten dy palë, e ne kemi vetëm Kosovën për të zbatuar apo pranuar marrëveshjen bazë. Znj. Kryeziu- Hyseni falënderoi ambasadorin për takimin dhe njoftoi se nga komisioni i është bërë ftesë komisionit homolog hungarez për vizitë në Kosovë, dhe posa ta kemi përgjigjen, do të fillojmë përgatitjet për takim.

Mbledhja përfundoi në orën 12:10.

E përgatiti:  
Stafi mbështetës i Komisionit.

Arbëreshë Kryeziu-Hyseni,

---

Kryetare e Komisionit